# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-432137**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ekskluzive në |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/915043/video-ahmetaj-zbardh-pergjimin-po-behet-trafik-armesh-vijne-nga-afrika-paketohen-ne-shqiperi-marrin-rruget/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 23:13:19 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 19:56:35 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b0ea2108e121a05cb54b7114d40007b5d9017e2f50fdede577ef83633ec48757` |
| TEKSTI | `3c35272be135d992901adb4930373170c88fcd9df25b68aea81272ecd260c904` |
| PAMJA | `887f91025607d44614ae00dfd248947de17f5cf349f5d15ec0cd034b76aaa150` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5d453e20551d5e53035a0126a374c8e27eb54547a87d9ba82879e846cc605e6b` |
| E MËPARSHMJA | `e7ccc6a69487a642a81fffe1e697b233c103a0dab9b866a5cb77fe4c7a75862a` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5d453e20551d5e53035a0126a374c8e27eb54547a87d9ba82879e846cc605e6b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

LAJMI I FUNDIT

LIVE/ 104 ditë protestë, qytetarët kërkojnë dorëheqjen e Ramës




# VIDEO/ Ahmetaj zbardh përgjimin: Po bëhet trafik armësh, vijnë nga Afrika paketohen në Shqipëri, marrin rrugët ...

**ZMADHO TEKSTIN21:56, 07/09/2026**

+ Aª -

*Në intervistën ekskluzive për 'Çim Peka LIVE' në SYRI TV, ish-zv/kryeministri Arben Ahmetaj ka ngritur akuza të forta edhe për industrinë ushtarake, duke deklaruar se armë vijnë nga Afrika, paketohen në Shqipëri për t'u dërguar më pas në zona konflikti.*

*Ai e ka lidhur këtë skemë me zyrtarë të lartë dhe me atë që e cilëson si 'kreu i organizatës', duke kërkuar hetim të menjëhershëm nga institucionet e drejtësisë.*

**Pjesë nga intervista ekskluzive:**

**ÇIM PEKA: Te episodi i dytë.**

**AUDIOPËRGJIMI-PJESA E DYTË:** VIDEO (Lart)

> **Transkripti**
>
> **Ron:** Qeverisë I duhet ta bëjë 100% pronë të agjencisë qeveritare<br>
> **Ron:** Më pas qeveria do të zgjedhë një agjenci bashkëpunuese me 100% me 100% aksione qeveritare dhe hyn në kompaninë që krijohet.<br>
> **Tatjana** përkthen në gjuhën ukrainase<br>
> **Ron:** Unë rekomandoj që aksionet tuaja në këtë kompani të mos jetë ukrainase por një koorporate amerikane sepse shumë më mirë të shfaqet si amerikane.<br>
> Kompania mburojë do të jetë kompani qeveritare.<br>
> Aksionet që ka Igori në kompaninë shtetërore do të zotërohen nga kompania Amerikane, çdo aksion.<br>
> Aksionet nuk do të zotërohen nga Igori, por nga një kompani amerikane e cila po hyn në partneritet me qeverinë shqiptare.<br>
> **Tatjana** përkthen në gjuhën ukrainase<br>
> **Ron:** Dhe kështu i mbyllim gojën Ambasadës Amerikane. I mbyllim gojën me kompaninë amerikane.<br>
> **Ron:** Kam një pyetje<br>
> **Ron:** Plani juaj nuk ndryshon, saktë<br>
> **Ron:** Ne do të marrim Vlorën, Saktë<br>
> **Ron:** Në Vlorë ne do të çojmë gazin. Nga atje në Vlorë<br>
> **Tatjana flet në anglisht:** Kompania jonë do të bëjë të mundur transferimin e gazit nga atje në Vlorë

**ARBEN AHMETAJ:** Tani, episodi i dytë shpjegon strukturën, vetë Roni. I thotë: 'Do ketë një kompani shtetërore mburojë'. Dhe abuzon, përveç strukturës kriminale për devijimin e pasurive të shqiptarëve, abuzon me respektin e shqiptarëve për SHBA-në. Thotë: 'Do krijojmë një trust në Amerikë që t'i mbyllim gojën ambasadës amerikane'.

Ky ustai që do të mirrte dhe borxhin, për të grabitur dhe Delvinën, po do marrim thotë edhe Vlorën, TEC-in e Vlorës. Plaçkitësja me këtë dreka darka i ka të evidentuara. Strukturë kriminale. Strukturë purifike kriminale për të grabitur Shqipërinë.

I kam thënë shqiptarëve. U them dhe protestës. Merrni hartën e Shqipërisë, po gjetët një copë tokë që ky nuk e ka shpërndarë aty ku i do qefi përmes ligjeve të investimeve strategjike.

A e dini sa metra katrorë ka dhënë përmes ligjit të investimeve strategjike?

2.1 milionë metra katrorë, ka dhënë ky, përmes Ligjit të investimeve strategjike. 2.1 milionë metra katrorë, pronë e shtetit, e qytetarë ia ka dhënë aty ku i do qejfi.

Ligji i investimeve strategjike kishte sens 3 vite, por në ekstrem 5 vjet po në ekstremitet 5 vjet, por jo 12 - 13 e 14 vjet që ti të grabitësh gjithçka që të del përpara me këdo që ti i futesh në shtëpi i del nga shtëpia, e ke në rreth, i bën atë që s'duhet bërë, pastaj i jep atë që s'duhet dhënë.Jo. Ligji i Investimeve Strategjike duhej të abrogohej dje. E duhej të vijë nga pseudo ose antikorrupsionistët brenda grupit të PS-së. Njëri nga ata, 2 nga ata, 10 nga ata. Le t'i kërcënojë siç i kërcënoi unë do bëj dhe listë deputetësh. Ndoshta po, e ndoshta jo. Por nuk i kërcënon përfaqësuesit e popullit me listë, se ke 30 vite në pushtet e ke bërë vetëm një gjë. Ke shthurrur ADN-në shtetformuese të Shqipërisë. Sot ADN-në shtetformuese e Shqipërisë është e sakatuar. Nuk ka institucione. Media e blerë. Parlamenti i sakatuar, i turpshëm. Institucionet janë duke u shitur me shërbimet. Për çfarë e për kë e ka bërë? Duhet tia thotë drejtësisë nëse do reflektojë por dhe shqiptarëve

**ÇIM PEKA: Vijmë te episodi i tretë.**

**AUDIOPËRGJIMI- PJESA E TRETË:** VIDEO (lart)

**Transkripti**
**Ron**: Kemi vendosur të shkojmë në Afrikë me biznesin e prodhimit. Unë mendoj se është biznes i mirë. Një biznes shumë i mirë. Përafërsisht qindra milionë që ne mund të bëjmë me prodhimin e municioneve.

**Tatjana:** Me KAYO-n. Saktë.
Përkthen në gjuhën ukrainase
**Sergei** flet në gjuhën ukrainase
**Tatjana:** Pra do të thuash (Ndërhyn Ron)
**Ron:** Në këtë moment unë kam dy, unë kam tre në Sudan dhe Nigeri.
**Sergei** flet në gjuhën ukrainase
**Ron:** Sergei ke qenë në Afrikë?
**Ron:** Hajde me mua në shkurt
**Igor** flet në gjuhën ukrainase
**Tatjana:**Nuk mund të vij
**Ron** për Igor. Do të të nisim foto.
Qeshin
**Ron:** Ti do të vish për të parë. Do të kuptosh Sudanin
**Ron: A** flet frëngjisht
**Sergei:**Vetëm gjermanisht
**Sergei** flet në gjuhën ukrainase, ndërhyn Ron Yffet
**Ron:** Porositë duhen bërë me para
**Sergei** flet në gjuhën ukrainase dhe përmend Gana, Angola dhe Nigeri
**Tatjana** përkthen në anglisht për Ron
**Tatjana:** Këto janë shtetet që Ron dhe Rafael zakonisht dërgojnë…
**Tatjana**: Nuk kuptohet
Sergei flet në gjuhën ukrainase
**Tatjana:** Ku dëshiron ta kesh paketimin, në cilin shtet?

**Roni:** Sigurisht në Shqipëri.
**Tatjana përkthen**: Në Shqipëri
**Tatjana:** Në Afrikë, ti po punon me KAYO sigurisht
**Ron**: Ne nuk e dimë atë

**ARBEN AHMETAJ:** Është vetëshpjeguese. Jemi duke folur për trafik ndërkombëtar armësh, jo në kuadër të marrëveshjes së NATO-s që ka Shqipëria me Ukrainën. Jemi duke folur për trafik armësh nga vendet e Afrikës që paketohen në Shqipëri dhe marrin rrugën.

**ÇIM PEKA: Si paketohet? Mbaj mend që ka thënë në Parlament ministri aktual i Mbrojtjes: 'Ne tashmë po prodhojmë armë dhe ato po përdoren në vende konflikti'.**

**ARBEN AHMETAJ:** Kemi shoqërinë Advanced Arms Technology, e cila prodhon armë. Pra, Roni, i borxhit, i KAYOs, i TEC-it të Vlorës, i rezervës së naftës, do të bëjë trafik armësh.

Ermal Raketa ka detyrim t'u tregojë shqiptarëve çfarë armësh? Kush i prodhon? Nga kanë ardhur? Zoti Raketa thotë që përdoren në zona konflikti aktuale. Kjo është gafë penale, nxjerr sekretin dhe tregon trafikun e armëve të fshehur pas koncesioneve kriminale.

© SYRI.net

**Lexo edhe:**

- VIDEO/ Ceno: Berisha fitoi betejën morale, diaspora do të jetë investitori strategjik i qeverisë së PD
- VIDEO/ Ahmetaj publikoi përgjimin në SYRI TV, protestuesi: Rama dhe Yeffeti, skema për shitjen e Shqipërisë
- Denoncimi/ Emigrantët shqiptarë bllokohen në Mal të Zi me urdhër të Ramës! Pengohen t'i bashkohen protestës

Më të lexuarat
Politikë

## Sula: PISA 2025 u shënua me yll, OECD e futi Shqipërinë në 'raportim të kufizuar', qeveria fshehu të vërtetën

Politikë

## Ju përmend emri në bisedën e Ron Yeffet me biznesmenët ukrainas, gazetari Julian Hoxhaj reagon pas audiopërgjimit

Politikë

## SYRI TV/ Ermal Nufi i ikën si 'raketë' pyetjeve të Syri Tv për audiopërgjimin

Politikë

## SYRI TV/ 'Kufizimi i takimeve të Metës, shqetësim serioz' , Komiteti i Helsinkit letër paraburgimit 313

Politikë

## Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Politikë

## Noka në 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës: Liria nuk dhurohet, për të duhet luftuar

Politikë

## SYRI TV/ Ngërçi për pagat e gjyqësorit përfundon në dyert e SPAK

Politikë

## SYRI TV/ Debate për audiopërgjimin e Ahmetajt, PD kërkon seanca dëgjimore për aferën

Politikë

## Kayo-Qeveria dhe Rama lakuriq, përse SPAK-u fshihet dhe nuk i sheh?

Politikë

## Bardhi: Rama hesht për audiopërgjimin ku miku i tij, Ron Yeffet, flet si i zgjedhur nga qeveria për të bërë punët e saj të këqija

**TË NGJASHME**

Politikë

## FOTOLAJM/ Pankartat pikante ndaj Ramës dhe Ballukut: "Tenderat në Tiranë, 'infinity pool' në Palasë"

Politikë

## Mediu për 11 Shtatorin: Bota ndryshoi përgjithmonë, shqiptarët krenarë që qëndruan në krah të SHBA

Politikë

## Televizioni francez: Protesta në Shqipëri është shndërruar në një mobilizim afatgjatë kundër modelit Rama

Politikë

## Skandaloze/ Nuri: Rama telefonoi protestuesin në administratë për ta frikësuar se pse proteston

Politikë

## A e ka marrë përsëri Allajbeu konçensionin?/ Diaverum fiton tenderin e dializës, grupi zotëron edhe DiaVita-n e PPP

Politikë

## Berisha denoncon: Ministri i ri i Brendshëm rrihet në zyrë, policia nuk e ndihmon

Politikë

## 'Territorialja' në Memaliaj/ Kryebashkiaku Albert Malaj dhe qytetarët braktis dëgjesën publike: Jo shkrirjes

- Botërori 2026
- Jetë/stil
- Trashëgimi
  - Histori
- Mjedis
  - Klimë
- Arkiva

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Search

Denonco

Merrni lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!

Në rregull

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.